



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republik of Kosova
Komuna e Obiliqit/Opstina Obilic/Municipality of Obiliq

Bazuar në nenin 17 shkronja h, nenin 62 paragrafin 62.3, të Ligjit nr.03/L040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 81 të Statutit të Komunës së Obiliqit nr.-I-34, datë 25.04.2020, nenet 6,8 dhe 18 të Rregullores Për Ndarjen E Bursave, Kompensimin E Shpenzimeve Të Udhëtimit Dhe Aktivitet Jashtëshkollorë, Nr. -I-104, të datës 31.08.2020, dhe kërkesën me nr.-X -618 të datës 09.09.2022, Drejtoria e Arsimit më 12.09.2022 korrigjon konkursin e publikuar me. Nr. -X-633, datë 09.09.2022:

KONKURS PËR BURSA TË NXËNËSVE PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA TË KOMUNËS SË
OBILIQIT
(Për vitin shkollor 2022-2023)

Kushtet:

- Të jenë banorë të Komunës së Obiliqit.
- Të jenë të regjistruar si nxënës për herë të parë në vitin shkollor për të cilin ndahet bursa.

1.Kriteret për të fituar bursën për nxënës të shkollave të mesme të larta janë:

- 1.1 Të jenë nxënës të rregullt dhe të vijojnë mësimin rregullisht, në shkollat e mesme të larta të Komunës së Obiliqit;
- 1.2 Për nxënës të Gjimnazit "17 Shkurti", të kenë të përfunduar klasën paraprake të shkollës së mesme të lartë me sukses të shkëlqyeshëm (përfshihet klasa e X-të);
- 1.3 Për nxënës të SHMLP "Ismail Dumoshi", të kenë të përfunduar klasën paraprake, me sukses të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të);
- 1.4 Për nxënës me nevoja të veçanta, fëmijë të dëshmorëve, nxënës familjet e të cilëve janë raste sociale, dhe nxënës jetimë (që nuk kanë asnjërin prind ose kanë vetëm njërin prind) të kenë të përfunduar klasën paraprake me sukses të shkëlqyeshëm (bursa ndahet edhe për klasën e X-të).

Dokumentet e kërkuara:

- Vërtetimin nga shkolla se janë regjistruar nxënës të rregullt në vitin shkollor 2022-2023
- Të kenë të përfunduar klasën paraprake me sukses të shkëlqyeshëm (dëftesat)
- Vërtetimin nga shkolla se nuk janë shfrytëzues të ndonjë burse tjetër
- Dëshmi mbi gjendjen ekonomike-sociale
- Letërnjoftimi ose Certifikatën e lindjes
- Konfirmimi bankar i nxënësit ose i njërit prind
- Letërnjoftimi i nxënësit ose i njërit prindërit

Sqarim: Letërnjoftimi dhe konfirmimi bankar duhet të jenë vetëm të njërit prind

Fletëkërkesat merren në Zyrën e pranimit të KK-së, ose në faqe zyrtare të komunës dhe dorëzohen me dokumente të kompletuara në të njëjtën Zyrë. Afati i konkurrimit është 15 ditë pune.

Drejtori :Sahit Zeqiri

